

VENDIM
Nr. 566, datë 29.7.2022

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE TË PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES
SË ORGANIZATAVE RINORE DHE ORGANIZATAVE PËR TË RINJTË, QË
PËRFITOJNË FINANCIME NGA FONDET GRANT NGA BUXHETI I SHTETIT, TË
DEDIKUARA PËR RININË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 15, të ligjit nr. 75/2019, “Për rininë”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Fondi grant për rininë

Agjencia Kombëtare e Rinisë (në vijim “AKR-ja”), nëpërmjet fondit grant të dedikuar për rininë, të miratuar në ligjin vjetor të buxhetit, financon projektet e propozuara nga organizatat rinore organizatat për të rinjtë dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Neni 2
Përkufizime

Në kuptim të këtij vendimi, termat e mëposhtëm nënkuptojnë:

a) “Autoritet financues”, institucioni përgjegjës për rininë, sipas kuptimit të nenit 8 të ligjit nr. 75/2019, “Për rininë”.

b) “Kandidat”, organizata rinore, organizata për të rinjtë dhe njësia e vetëqeverisjes vendore, që merr pjesë në një procedurë konkurrimi, sipas këtij vendimi.

c) “Grant”, shuma e përcaktuar e fondit për mbështetjen e projektpropozimeve për të rinjtë, e shpallur në dokumentet e konkurrimit gjatë një procedure të parashikuar. Kjo shumë i jepet subjektit përfitues nga AKR-ja, në përputhje me kriteret e vendosura sipas këtij vendimi dhe legjislacionit në fuqi.

ç) “Dokumentet e konkurrimit”, dokumentet që AKR-ja vë në dispozicion të të gjithë kandidatëve të interesuar për përgatitjen e projektpropozimeve.

d) “Komisioni i vlerësimit të projektpropozimeve” (në vijim “komisioni”), organi vlerësues i projektpropozimeve të kandidatëve për përfitimin e fondeve grant për rininë, i ngritur sipas këtij vendimi;

dh) “Donator”, organizata, institucioni, enti apo organi, kombëtar e ndërkombëtar, publik apo privat, që mbështet përzgjedhjen dhe zbatimin e projektpropozimeve të kandidatëve në një thirrje konkurruese të AKR-së, duke angazhuar ekspertizën e vet dhe financimin shtesë mbi fondin grant, të përcaktuar për rininë në buxhetin e shtetit.

Neni 3
Parimet e shpërndarjes së fondeve

Procesi i shqyrtimit të projektpropozimeve, përzgjedhjes së projekteve dhe kandidatëve përfitues e i shpërndarjes së fondeve për mbështetjen e projekteve për të rinjtë mbështetet në parimet e mëposhtme:

- a) lirisë në pjesëmarrje e konkurrim;
- b) mosdiskriminimit e trajtimit të barabartë;
- c) transparencës së procedurave të vendimmarrjes, duke u mundësuar të gjithë kandidatëve informacionin për procedurën përkatëse;
- ç) përputhshmërisë me objektivat e grantit dhe me efektivitetin e përdorimit të burimeve, në bazë të sistemit të konkurimit dhe të kriterëve, që mundësojnë vlerësimin e projektpropozimit e të specifikimeve teknike dhe financiare për përzgjedhjen e shpërndarjen e grantit;
- d) mungesës së prapaveprimtari, duke përjashtuar mundësinë e shpërndarjes së fondeve për veprimtari të realizuara në datën e vendimmarrjes;
- dh) paanshmërisë së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe parandalimit të konfliktit të interesave;
- e) përjashtimit të mbivendosjes, që nënkupton shmangien e financimit të së njëjtës veprimtari për të njëjtin interes konkret, më shumë se një herë, brenda të njëjtit vit financiar.

KREU II KRITERET PËR PËRFITIMIN E GRANTEVE NGA KANDIDATËT

Neni 4 **Organizata rinore**

Organizata rinore mund të kërkojë të përfitojë mbështetje financiare, pas plotësimit të kriterëve të përcaktuara në nenin 11, të ligjit nr. 75/2019, “Për rininë”, si dhe të kriterëve të mëposhtme:

- a) të mos jetë në proces shpërndarjeje ose likuidimi;
- b) të mos ketë detyrime tatimore apo kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të pashlyera;
- c) përfaqësuesi i saj ligjor të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Neni 5 **Organizata për të rinjtë**

Organizata për të rinjtë mund të kërkojë të përfitojë mbështetje financiare pas plotësimit të kriterëve të përcaktuara në nenin 12, të ligjit nr. 75/2019, “Për rininë”, si dhe të kriterëve të mëposhtme:

- a) të mos jetë në proces shpërndarjeje ose likuidimi;
- b) të mos ketë detyrime tatimore apo kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të pashlyera;
- c) përfaqësuesi i saj ligjor të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Neni 6 **Njësia e vetëqeverisjes vendore**

Njësia e vetëqeverisjes vendore, sipas pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 75/2019, “Për rininë”, mund të kërkojë të përfitojë mbështetje financiare pas plotësimit të kriterëve të mëposhtme:

- a) të paraqesë projektpropozimin me objekt zhvillimin e infrastrukturës rinore;
- b) të paraqesë shprehjen e interesit të miratuar nga kryetari i bashkisë.

KREU III DETYRAT E STRUKTURAVE PËRGJEGJËSE PËR DHËNIEN E GRANTEVE PËR RININË

Neni 7

Agjencia Kombëtare e Rinisë

1. AKR-ja shpall çdo vit programin vjetor të financimit për projektet e kandidatëve.
2. AKR-ja harton e publikon dokumentacionin mbështetës për zhvillimin e procedurës konkurruese të përfitimit të granteve për rininë, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në këtë vendim, ku përfshihen:
 - a) thirrjet publike për projektpropozime nga ana e organizatave rinore, organizatave për të rinjtë dhe njësive të vetëqeverisjes vendore;
 - b) fondi në dispozicion për çdo thirrje për projektpropozime;
 - c) dokumentet për përgatitjen e dorëzimit të projektpropozimeve;
 - ç) formularët e kërkesës;
 - d) kontrata tip;
 - dh) udhëzime të detajuara, të cilat përmbajnë informacion, për:
 - i. mënyrën e shpërndarjes së fondeve dhe zbatimin e projektit;
 - ii. procedurën e zbatuar;
 - iii. kriteret minimale të kualifikimit dhe dokumentacionin, që provon plotësimin e tyre;
 - iv. kushtet e grantit;
 - v. afatet kohore dhe formalitetet, që duhet të respektohen;
 - vi. kriteret e përdorura për përzgjedhjen e kandidatëve;
 - vii. ndarjen e zërave në terma financiarë;
 - viii. mënyrën e vlerësimit të projektpropozimeve;
 - ix. detyrimet e raportimit për zbatimin e projektit;
 - x. mënyrën e kryerjes së monitorimit të projekteve;
 - e) ndryshimet e kryera dhe sqarimet e bëra përgjatë procedurës;
 - ë) listën e projektpropozimeve dhe të kandidatëve pjesëmarrës për përfitimin e granteve;
 - f) vlerësimet përfundimtare të projektpropozimeve, kryer nga komisioni dhe miratuar nga ministri përgjegjës për rininë.
3. AKR-ja njofton kandidatin pjesëmarrës në procedurat konkurruese, për:
 - a) përzgjedhjen e projektpropozimit për financim;
 - b) përzgjedhjen e kushtëzuar të projektpropozimit për financim dhe kërkesën për rishikim të tij, bazuar në rekomandimet e komisionit;
 - c) mospërzgjedhjen e projektpropozimit për financim, të drejtën për të kërkuar arsyetimin e vendimmarrjes dhe të drejtën për ankim;
4. AKR-ja kryen procedurën e negociimit me kandidatin e përzgjedhur dhe nënshkruan kontratën e financimit të projektit;
5. AKR-ja monitoron zbatimin e projekteve të financuara dhe përgatit vlerësimin e performancës të fondit grant për rininë.

Neni 8

Ngritja e komisionit të vlerësimit të projektpropozimeve

1. Komisioni i vlerësimit të projektpropozimeve ngrihet në bazë të këtij vendimi dhe përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë të emëruar nga ministri përgjegjës për rininë, me mandat kohëzgjatjeje në detyrë, që përkon me periudhën e zbatimit të thirrjes nga AKR-ja, të përzgjedhur, si vijon:
 - a) 2 (dy) anëtarë të caktuar nga ministri përgjegjës për rininë, ku njëri ruan rolin e kryetarit të komisionit;
 - b) 1 (një) anëtar i caktuar nga titullari i AKR-së;
 - c) 2 (dy) anëtarë ekspertë nga shoqëria civile me ekspertizë në vlerësimin e projekteve zhvillimore dhe me ndikim tek të rinjtë.

2. Kur një donator apo grup donatorësh angazhohen të mbështesin thirrjen e AKR-së, ruan të drejtën e propozimit të një anëtari në përbërje të komisionit. Në këtë rast, komisioni do të përbëhet nga 6 (gjashtë) anëtarë.

3. Anëtari i komisionit, i caktuar sipas shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 1, të këtij neni, duhet të plotësojë kushtet dhe kriteret e mëposhtme:

a) të jetë nëpunës i administratës shtetërore;

b) të ketë si pjesë të detyrave funksionale hartimin, zbatimin ose monitorimin e politikave, programeve dhe projekteve për rininë.

4. Anëtari i komisionit, ekspert nga shoqëria civile, parashikuar në shkronjën “c”, të pikës 1, të këtij neni, përzgjidhet mbi bazën e një procesi konkurrimi, pas shpalljes së thirrjes publike, bazuar në plotësimin e kushteve e të kriterëve të mëposhtme:

a) të ketë mbaruar studimet universitare “master” për drejtësi, administrim publik, shkenca ekonomike apo shkenca shoqërore;

b) të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë;

c) të ketë mbi 10 (dhjetë) vjet përvojë pune;

ç) të ketë përvojë të mëparshme në vlerësimin e projektpropozimeve të organizatave të shoqërisë civile në thirrje konkurruese për financim;

d) të ketë përvojë në përgatitjen, zbatimin, monitorimin dhe/ose vlerësimin e projektpropozimeve të financuara me fonde publike;

dh) të ketë njohuri në fushën e politikave dhe çështjeve rinore.

5. Ministri përgjegjës për rininë, në përfundim të procesit të konkurrimit për anëtarët, ekspertë nga shoqëria civile, shpall fitues 2 (dy) aplikantët e vlerësuar me pikët më të larta nga konkurrimi, në cilësinë e anëtarit të komisionit, dhe 2 (dy) aplikantët e renditur të dytët, në cilësinë e zëvendësuesit, në rastin e krijimit të vakancës nga ekspertët e parë.

6. Ministri përgjegjës për rininë ngarkohet të hartojë termat e referencës, afatin e aplikimit, si dhe të menaxhojë procesin e konkurrimit e të përzgjedhjes së tyre.

7. Anëtari i komisionit, i caktuar sipas pikës 2 të këtij vendimi, duhet të plotësojë të njëjtat kushte dhe kriteret të parashikuara për anëtarin ekspert nga shoqëria civile në komision.

8. AKR-ja ushtron detyrën e sekretariatit të komisionit nëpërmjet punonjësve të ngarkuar nga titullari.

Neni 9

Kompetencat e komisionit

Komisioni ushtron këto detyra dhe kompetenca:

a) shqyrton e vlerëson çdo projektpropozim;

b) plotëson formularët e vlerësimit për çdo projektpropozim të dorëzuar dhe anëtarët e tij japin pikët individuale;

c) përgatit renditjen paraprake të projektpropozimeve bazuar në pikëzimin dhe vendimmarrjen e të gjithë anëtarëve dhe, sipas rastit, përgatit rekomandimet për rishikim të projektpropozimeve individuale, me qëllim përmirësimin e tyre;

ç) harton e nënshkruan procesverbalin e vlerësimit të projektpropozimeve dhe listën e projekteve të përzgjedhura për financim.

KREU IV

PROCEDURA PËR PËRZGJEDHJEN E PROJEKTEVE DHE DHËNIEN E GRANTEVE PËR RININË

Neni 10

Analiza e problematikave dhe përcaktimi i përparësive

1. Ministri përgjegjës për rininë kryen çdo vit analizën e mundësive dhe të problematikave për rininë, bazuar në nevojat e identifikuara dhe prioritetet për rininë në strategjitë, planet e veprimt, politikat e programet në nivel qendror dhe vendor.

2. Ministri përgjegjës për rininë përcakton objektivat dhe fushat e përparësisë së grantit për rininë, për të cilat zhvillohen thirrjet konkurruese për projektpropozime, pas këshillimit në Këshillin Kombëtar të Rinisë.

Neni 11

Shpallja, dokumentet e aplikimit dhe afati i thirrjes

1. AKR-ja shpall thirrjet konkurruese për projektpropozime dhe publikon rregullat për përgatitjen e dorëzimit të dokumentacionit mbështetës për kandidatët, pas miratimit të tyre nga ministri përgjegjës për rininë. Paketa e dokumenteve të aplikimit përmban udhëzuesin për kandidatët, formularët për përgatitjen e projektpropozimit dhe kriteret e përzgjedhjes së tij.

2. Organizata rinore dhe organizata për të rinjtë, që merr pjesë në thirrjen e shpallur për konkurrim, plotëson dokumentet e aplikimit të thirrjes dhe dorëzon dokumentacionin, që provon plotësimin e kriterëve të përcaktuara, sipas rastit, në nenet 4 ose 5 të këtij vendimi, si dhe dokumentet e mëposhtme:

a) kopje të aktit të regjistrimit në gjykatë;

b) kopje të statutit të OJF-së, ku specifikohet si pjesë e veprimtarisë së saj dhe zhvillimi i aktiviteteve rinore;

c) pasqyrat financiare të dorëzuara për vitin e fundit.

3. AKR-ja përcakton në thirrjen e shpallur për konkurrim afatin e dorëzimit të projektpropozimeve, i cili nuk mund të jetë më i vogël se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga data e shpalljes së thirrjes.

Neni 12

Elementet e projektpropozimit dhe kostot e lejuara

1. Projektpropozimi i dorëzuar në thirrjen konkurruese të AKR-së përmban informacion dhe të dhëna mbi qëllimin, karakteristikat, fushën e përparësisë, objektivat specifike, veprimtaritë e parashikuara, buxhetin dhe rezultatet e synuara.

2. Granti nuk do të përdoret në asnjë rast për financimin e kostove operative të subjektit përfitues, përtej atyre të miratuara në projektin e përzgjedhur.

Neni 13

Vlerësimi i projektpropozimit

Komisioni shqyrton e vlerëson çdo projektpropozim të dorëzuar në thirrjen konkurruese të AKR-së, bazuar në kriteret, procedurat, dokumentacionin dhe afatet e thirrjes publike, të përcaktuara në këtë vendim.

Neni 14

Hartimi i procesverbalit të vlerësimit të projektpropozimeve

1. Komisioni, në përfundim të procesit të vlerësimit, harton procesverbalin e vlerësimit të projektpropozimeve të dorëzuara nga kandidatët në thirrjen konkurruese të AKR-së.

2. Procesverbali përmban renditjen e projektpropozimeve të shqyrtuara bazuar në pikëzimin e të gjithë anëtarëve të komisionit, vendimmarrjen e arsyetuar për çdo projektpropozim, rekomandimet

për rishikim të një projektpropozimi të përzgjedhur me kusht për financim dhe informacionin për projektet e shkualifikuara për mungesë dokumentacioni.

3. Procesverbalit nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit dhe administrohet nga AKR-ja.

Neni 15

Miratimi i procesverbalit të vlerësimit të projektpropozimeve

1. AKR-ja, brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e përfundimit të procesit të vlerësimit, përcjell për miratim pranë ministrit përgjegjës për rininë procesverbalin e vlerësimit të projektpropozimeve dhe dokumentacionin shoqërues.

2. Ministri, brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e marrjes së dokumentacionit, miraton procesverbalin e vlerësimit të projektpropozimeve ose e rikthen atë pranë komisionit, të shoqëruar me vërejtjet përkatëse.

3. Komisioni reflekton vërejtjet e ministrit në procesverbal dhe AKR-ja përcjell dokumentacionin e rishikuar për miratim, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë kalendarike nga data e kthimit të procesverbalit nga ministri.

Neni 16

Publikimi i rezultateve të thirrjes

1. AKR-ja, brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e miratimit të procesverbalit të vlerësimit të projektpropozimeve, publikon në faqen zyrtare të saj informacion mbi vlerësimin e projektpropozimeve.

2. Afati për vlerësimin e projektpropozimeve dhe publikimin e rezultateve të thirrjes është jo më shumë se 45 (dyzet e pesë) ditë kalendarike nga data e përcaktuar në dokumentet e konkurrimit për dorëzimin e projektpropozimeve të kandidatëve.

Neni 17

Njoftimi i kandidatëve dhe negocimi i kontratës

1. AKR-ja, brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e miratimit të procesverbalit të vlerësimit të projektpropozimeve, njofton kandidatin për përzgjedhjen e projektpropozimit për financim.

2. Kur projektpropozimi është përzgjedhur me kusht, AKR-ja i kërkon kandidatin miratimin e tij, brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike, për reflektimin e rekomandimeve të komisionit për rishikimin e projektpropozimit. Kandidati, që nuk shprehet brenda këtij afati apo refuzon të rishikojë projektpropozimin, bazuar në këto rekomandime, skualifikohet e humb të drejtën e mbështetjes me fondet grant për rininë. Në këtë rast, AKR-ja njofton kandidatin pasardhës në listë dhe e fton në procesin e negocimit, në përputhje me parashikimet e këtij neni.

3. AKR-ja, brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e miratimit të procesverbalit të vlerësimit të projektpropozimeve, njofton kandidatin e përzgjedhur jofitues mbi rezultatin e vlerësimit, hapat për të kërkuar arsyetimin e vendimit dhe procedurën e ankimit.

4. Agjencia Kombëtare e Rinisë, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve kalendarike nga data e përfundimit të procesit të vlerësimit, përfundon procedurën e negocimit me çdo kandidat të përzgjedhur për financim dhe përcjell për miratim pranë ministrit përgjegjës për rininë listën e rishikuar me projektet fituese, përshkrimin e projekteve dhe shumat përfundimtare të granteve për financim.

Neni 18

E drejta e ankimit

Kandidati i përzgjedhur jofitues ka të drejtë të paraqesë ankim administrativ pranë ministrit përgjegjës për rininë. Rregullat, procedurat dhe afatet kohore të ankimit administrativ bazohen në dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative.

Neni 19

Nënshkrimi i kontratës së grantit

1. AKR-ja dhe subjekti përfitues nënshkruajnë kontratën e grantit të projektit, brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga miratimi i listës së projektpropozimeve fituese nga ministri përgjegjës për rininë.

2. Kontrata e grantit përcakton rregullat, afatet e përgjegjësitë e palëve për realizimin e projektit, dokumentacionin dhe afatet për raportimin përshkrues dhe financiar, mënyrën e transferimit të fondeve, shpenzimet e njohura e të pranueshme, mekanizmat e raportimit e të kontrollit, përfshirë detyrimin e subjektit përfitues për të vënë në dispozicion të Kontrollit të Lartë të Shtetit dokumentacionin për veprimtarinë financiare të kryer, mënyrën e dokumentimit të shpenzimeve të kryera dhe të produkteve e aktiviteteve të realizuara.

Neni 20

Livrimi i fondeve të projektit

1. Organizatës rinore dhe organizatës për të rinjtë u livrohet fondi për projektin në 3 (tri) këste:

a) kësti i parë: 50 (pesëdhjetë) % të vlerës së fondit menjëherë pas nënshkrimit të kontratës së grantit;

b) kësti i dytë: 40 (dyzet) % të vlerës së fondit, menjëherë pas miratimit nga AKR-ja të raportit përshkrues e financiar të fazës së parë;

c) kësti i tretë: 10 (dhjetë) % e vlerës së fondit, pas miratimit nga AKR-ja të raportit përshkrues dhe financiar përfundimtar.

2. Njësisë së vetëqeverisjes vendore u livrohet fondi për projektin në 2 (dy) këste:

a) kësti i parë: 90 (nëntëdhjetë) % të vlerës së fondit menjëherë pas lidhjes së kontratës së grantit;

b) kësti i dytë: 10 (dhjetë) % të vlerës së fondit, menjëherë pas miratimit nga AKR-ja të raportit përshkrues e financiar përfundimtar.

Neni 21

Raportimi, monitorimi dhe vlerësimi i granteve për rininë

1. Subjekti përfitues raporton pranë AKR-së mbi ecurinë e zbatimit të projektit, bazuar në kushtet dhe afatet e përcaktuara në kontratën e grantit, udhëzuesin për raportimin periodik të progresit dhe dokumentet mbështetëse të raportimit, të cilat miratohen nga ministri përgjegjës për rininë.

2. AKR-ja kryen monitorimin e zbatimit të projekteve dhe raporton për mbarëvajtjen e tyre pranë ministrit përgjegjës për rininë.

3. AKR-ja kryen çdo vit vlerësimin e performancës së fondit grant për rininë, që përfshin vlerësimin e menaxhimit të thirrjes nga AKR-ja, si dhe rezultatet dhe ndikimin e arritur nga projektet e financuara. Vlerësimi kryhet brenda 3 (tre) muajve nga përfundimi i zbatimit të projekteve të mbështetura në një program vjetor financimi dhe përmban, të paktën, elementet e mëposhtme:

a) informacionin mbi thirrjet publike të zbatuara, sasinë e fondeve të shpërndara dhe shpenzimet e realizuara;

b) informacionin mbi numrin e aplikimeve të thirrjes dhe përshkrimin e cilësive dhe të të metave të projektpropozimeve të kandidatëve;

c) informacion mbi arritjet e ndikimin e projekteve të mbështetura dhe kontributin e tyre për realizimin e objektivave të shpallur të thirrjes publike;

ç) numrin e ankimeve administrative të paraqitura dhe vendimet përfundimtare të shqyrtimit të tyre.

V. DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 22

Institucionet e ngarkuara për zbatimin e vendimit

Ngarkohen ministri përgjegjës për rininë dhe institucioni përgjegjës për rininë për zbatimin e këtij vendimi.

Neni 23

Shfuqizime

Vendimi nr. 1141, datë 24.12.2020, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave të përzgjedhjes së organizatave rinore dhe/ose për të rinjtë, që përfitojnë financime nga fondet grant nga buxheti i shtetit, të dedikuara për rininë”, shfuqizohet.

Neni 24

Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama